

UDHËHEQJA NUK KËRKON GJINI



NE SI QYTETARË

MIFETA (11), ARTI (11), ERLETA (11), VLERA (10), DIOR (11), TONIN (11), AMAR (11)

Të gjithë ne si qytetarë kemi të drejta dhe role të ndryshme në shoqërinë tonë. Prandaj, nëse dëshironi të njohoheni më shumë, ju lutem lexojeni këtë artikull!

Përshëndetje për juve lexues. Ne do të flasim për qytetarët në demokraci.

Për të qenë qytetar i një shteti duhet të jesh banor i shtetit përkatës, si dhe të kesh certifikatën e lindjes e cila simbolizon që tashmë je një qytetar. Të gjitha të dhënat tona si: emri, mbiemri, emri i prindërve, data dhe vendi i lindjes, hyjnë tek Regjistri Civil. Këtë regjistër çdo komunë duhet ta ketë.

Çdo qytetar mund të jetë aktiv. Qytetarë aktiv mund të jemi edhe kur bëjmë punë vullnetare. Ata krijojnë dhe janë pjesë e një komuniteti apo grupi. Përpos kësaj, ata mund të jenë pjesë e disa komuniteteve në të njëjtën kohë. Për të lehtësuar këto punë është i nevojshëm bashkëpunimi, por gjithashtu komunikimi jep ndihmë në arritjen e qëllimeve tona. Ndaj qytetarëve


të tjerë duhet të kemi respekt dhe sjellje të mirë.

Ata mund të: votojnë, ankohen në institucionet përkatëse, protestojnë për çështje të ndryshme, krijojnë OJQ, fillojnë fushatë vetëdijësuese, marshojnë në rrugët e komunitetit të tyre, takohen me përfaqësuesit e tyre, etj.


Edhe pse ne jemi fëmijë, ne kemi një plan në mendje. Plani ynë ka të bëjë me krijimin e një grup fëmijësh, ku ne në atë grup do të mund të mbledhim fonde të mjaftueshme për të blerë libra shkollore.

Këto libra do t'i marrin nxënësit të cilët nuk kanë mundësi t'i blejnë vetë ato. Kjo sepse të gjithë kemi të drejtën të mësojmë dhe të edukohemi. Faleminderit të gjithëve që ndatë kohën tuaj për ne!

Mos harroni të bëheni qytetarë aktiv edhe ju.



Të gjithë ne, qytetarët e Kosovës regjistrohemi në këtë libër



E drejta e votës është tejet e rëndësishme për neve




Respektoni të drejtat tona



Autorët dhe piktorët e këtij artikulli të mrekullueshëm

UNË I MBROJ VOTAT E QYTETARËVE

ERION (11), KLESTA (11), DIANA (10), LEONARD (11), VIOLA (10), ARITA (11), ARION (10), OLTION (11)



Vlera ime është shumë e madhe, sepse unë i qëndroj besnike çdo qytetari të Kosovës. Se kush jam unë do ta zbuloni në artikullin më poshtë

Lexues të dashur, jam shumë e lumtur që sot kam rastin t'iu tregoj më shumë për veten time. Falë këtij artikulli, shumë nxënës të tjerë do të mësojnë për rolin dhe rëndësinë time. Unë përbëhem prej gjashtë faqeve dhe zakonisht kam formën e kubit. Jam shumë e përdorur nga të gjithë. Mbjaj mend rastet kur më kanë përdorur për të zgjedhur kryetarin/en e klasës, më kanë përdorur për të zgjedhur përfaqësuesin/en e lagjes, si dhe më kanë përdorur për t'i zgjedhur përfaqësuesit e shtetit. A e dini ju se sa e lumtur ndihesha kur isha edhe në mesin e deputetëve kur ata propozonin ligje? Unë iu ndihmoja atyre që të miratoheshin ato.

Roli im parësor është që t'i ruaj mendimet dhe dëshirat e popullit. Zgjedhja e popullit është shumë e mirëpritur për mua. Prandaj, fletat e tyre të votimit i ruaj me shumë kujdes. Unë jam e para që i di rezultatet e popullit për personat që i kanë votuar. Mirëpo, nuk i them deri në momentin e fundit, sepse ato janë sekret im i vetëm. Ndhem shumë krenare për nxënësit që çdoherë më vizatojnë dhe më ngjyrosin. E di se këtë e bëjnë nga dashuria që kanë për mua. Më pëlqejnë rastet kur të tjerët më trajtojnë me shumë respekt, andaj dua që të gjithë të kenë besim tek unë. Vota e secilit peshon njëjtë për mua. Nuk bëj asnjë lloj dallimi, ngase të gjithë qytetarët kanë të drejta të bara-




barta. Unë jam e hapur për të gjithë ata që më trajtojnë në mënyrën e duhur dhe nuk manipulojnë me votën e tyre. E gjetët dot se kush jam unë? Unë jam kutia që mbajta të gjitha votat e qytetarëve dhe zgjedha përfaqësuesit e tyre. Andaj, ju premtoj që gjithmonë do të bëj punë të përgjegjshme që ju të jeni të lumtur me votat që i keni dhënë. Ju do kutia e votimit!



Buzëqesh çdo ditë

NE JEMI PJESË E KUVENDIT

ALENA (10), BELINA (11), RINOR (10), DIELL (10), BESIME (10), DION (10), ELIZA (10), ROLAND (12)



Ka rëndësi dhe vlerë shumë të madhe kur nxënësit shkruajnë dhe informojnë nxënësit e tjerë për demokracinë e shumë tema të tjera. Tema jonë është Kuvendi, dhe ne presim nga ju të dashur lexues që kur ta lexoni këtë temë, t'ia përsëritni vetes çdo informatë të re në mënyrë që të mos i harroni. Vini re, Informacionet janë tejet të rëndësishme!

Ambienti është hapësira që na rrethon, por edhe më gjerë. Për këtë arsye duhet që ai të jetë i pastër dhe i freskët. Ne e dimë që jo të gjithë qytetarët janë të përgjegjshëm dhe kujdesen për ambientin që i rrethon. Për faktin që është shumë e rëndësishme për qytetarët, mbrojtja e ambientit është e rregulluar edhe me ligj. E për të gjithë ata qytetarë të cilët veprojnë në kundërshtim më ligjin, ka edhe pasoja.

Edhe ne si nxënës e vlerësojmë shumë këtë gjë, sepse për ne është shumë i rëndësishëm ambienti. Aq sa është e rëndësishme ruajtja e ambientit, po aq i rëndësishëm është fakti që qytetarët t'i dinjë përgjegjësitë e veta. Kur ne qytetarët veprojmë sipas ligjit, atëherë, të gjithë kemi jetë më të mirë dhe jetojmë në harmoni me njëri-tjetrin. Këtë e kërkon edhe demokracia, e cila synon gjithmonë angazhimin e qytetarëve, barazinë, lirinë, e shumë e shumë elemente të tjera. Kur ne i përditësojmë të gjitha këto elemente, atëherë ne jetojmë në harmoni.

Por, pas gjithë kësaj që e thamë ekziston një institucion i cili punon dhe angazhohet shumë që këto elemente apo vlera veç të rriten. Ky institucion është Kuvendi i Kosovës, i cili ndryshe njihet si „Shtëpia e Popullit“.

Pse qytetarët e quajnë Kuvendin „Shtëpia e Popullit“? Kuvendi i Kosovës është i vetmi institucion i vendit

tonë i cili zgjedhet direkt nga populli. Për këtë përgjegjësitë e tij ndaj popullit janë të shumta. Ashtu siç edhe ne qytetarët e kemi përgjegjësi t'i zgjedhim deputetët. Si detyrë kryesore e Kuvendit është miratimi i ligjeve. Ndërsa, përgjegjësia jonë në këtë aspekt është respektimi i atyre ligjeve. Janë gjithsej 120 deputetë të cilët merren me propozimin, aprovimin apo mos aprovimin e ligjeve. Këto ligje e sistemojnë jetën e qytetarëve. Kjo është një ndër arsyet se pse Kuvendit ndonjëherë i referohemi si „Shtëpia e Popullit“.

Mirëpo, Kuvendi ka edhe disa funksione të tjera si: përfaqësimi i popullit dhe kontrollimi i punës së Qeverisë. Në këtë faqe jemi munduar që të bëjmë një lidhje mes funksionit legjislativ dhe jetës sonë. Kurse, në faqen tjetër lexoni më shumë për dy funksionet e tjera të Kuvendit.



Si rezultat i bashkëpunimit tonë, e shkruajtëm artikullin



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Thimi Mitko“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-6
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjilan